

Reforma e Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Republikës së Shqipërisë, 2007

Dokument për Politikat, përfundimtar

Janet Dine, Michael Blecher

Në këtë dokument politikash jepet një përmbledhje e kërkesave ligjore të BE-së, MSA-së dhe ato ndërkombëtare për reformën shqiptare të legjislacionit për shoqëritë tregtare si dhe sugjerimet e bëra nga pjesëmarrësit në Tryezën e Rrumbullakët të datës 9 maj 2007 dhe në Pyetësorin e shpërndarën pas Tryezës së Rrumbullakët. Gjatë kësaj kohe kemi pasur mundur të mësojnë nga aktivitete të tjera në këtë fushë, sidomos nga analiza e drejtimit të brendshëm të shoqërive i cili është kryer nga Shoqata Shqiptar-Amerikane për Tregti dhe Zhvillim (AATDA). Jemi përpjekur të marrim në konsideratë edhe rezultatet e tryezave të rrumbullakëta të AATDA.

Dëshirojmë të falënderojmë të gjitha ta që deri tani kanë marrë pjesë në diskutimin për reformën, për gatishmërinë që kanë treguar për të na mbështetur përmes kontributit të tyre të vlefshëm në lidhje me doktrinën dhe praktikën në vend. Ekziston mendimi i përgjithshëm se reforma e legjislacionit për shoqëritë tregtare duhet të ofrojë një sistem bashkëkohor, të qartë dhe të përditësuar, në mënyrë që të jetë i aftë të thithë investime të thuaja. Më poshtë jepet jemi përpjekur të pasqyrojmë argumentet që janë theksuar gjatë Tryezës së Rrumbullakët dhe Pyetësorit, dhe t'i lidhim ato me një strukturë të mundshme të *Ligjit Shqiptar për Njësitë Ekonomike*.¹ Supozohet, që në bazë të kësaj të bëhet një raund tjetër diskutimesh.

1. Mbrojtja e Palëve të Treta të cilat kanë Marrëdhënie me Shoqërinë

Me zhvillimin e gjërave, vendet anëtare të BE-së kanë hequr dorë nga kërkesa ligjore për palët e treta që këto të fundit të hetojnë dhe të sigurojnë që personi me të cilin hyjnë në marrëdhënie tregtare të ketë autoritetin e vërtetë për të lidhur një kontratë. Kjo nxit besimin për marrëdhëniet tregtare midis të huajve dhe shoqërive tregtare vendase dhe mund të nxisë edhe pakësimin e burokracisë e cila shkakton një ngadalësim të ndjeshëm të punës. Rreziku në lidhje me miratimin për zbatim të këtij sistemi është se mund të bëhen përfaqësime të rreme nga persona të cilët nuk kanë lidhje me shoqërinë tregtare në emër të së cilës thonë se veprojnë. Kjo gjë mund të evitohet me anë të një dispozite, që të parashikojë

¹ Dokumenti në të cilin jepet më shumë informacion me hollësi për reformat e mundshme mund të gjendet në Zyrën e GTZ-së pranë Ministrisë së Integritimit; personi i kontaktit: Zonja Blerina Raça, Telefon dhe faks: ++ 355 4 273424; adresa e postës elektronike: gtz.eu@icc-al.org

përgjegjësinë e një kompanie vetëm kur pala e tretë ka arsye të mjaftueshme për të besuar se ka të bëjë me një përfaqësues bona fide të kompanisë. Kjo bëhet zakonisht kur kompania ka bërë diçka, që e bën palën e tretë të kuptojë se kështu ka ndodhur.

Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët dhe disa prej pjesëmarrësve në pyetësor ishin në favor të sugjerimit që në Shqipëri të miratohet një sistem konsekuent i cili i çliron palët e treta nga detyrimi për të hetuar në punët e brendshme të shoqërisë tregtare, së bashku me një rregull për “besimin e areyshëm”. Kjo mund të shoqërohej me ndëshkime penale për përfaqësuesit e rremë të autoritetit.²

Mirëpo, disa pjesëmarrës të tjerë në pyetësor kishin kritika në lidhje me këto propozime. Ata kanë theksuar se ligji shqiptar nuk mundëson klauzola të tilla të përgjithshme, siç është “besimi i arsyeshëm”. Ne besojmë në lidhje me këtë formulë ka një keqkuptim. Në faqen 6 të versionit të gjatë të dokumentit kumtesë për diskutim, kemi vendosur mënyrën e të shprehurit që përdoret në Direktivën e Parë dhe kemi treguar kufizimin që rrjedh nga e Drejta Evropiane për ta përgjithësuar këtë kriter në legjisllacionin shqiptar. “Besimi i Arsyeshëm” do të thotë thjesht që ***shoqëria tregtare nuk është e lidhur me detyrim ligjor nëse vërteton që pala e tretë ishte në dijeni të parregullsisë ose nuk mund të mos ishte në dijeni të kësaj parregullsie, nëse mbahen parasysh rrethanat përkatëse evidente; bërja me dije e statuteve në vetvete nuk përbën provë të mjaftueshme për këtë qëllim.*** Për secilën çështje gjyqësore, gjykatat duhet të përcaktojnë nëse “rrethanat evidente” flasin në favor ose kundër palës së tretë. Kjo detyrë për të interpretuar bën pjesë në rolin e gjykatësve, si në Shqipëri ashtu edhe në vende të tjera evropiane, ka apo nuk ka një rregull për t’u mbështetur në precedentët me detyrim ligjore. Të gjithë e dimë se ligji nuk mund të jetë kurrë aq konkret sa për të mos shmangur këto hapësira për interpretim. Kompetenca për vetëvendosje në raste të tilla kufizohet nga rregullat juridike të argumentimit (nga analizë fjalë-për-fjalë, historike, sistematike dhe teleologjike). Dhe sigurisht, palët e treta, si edhe ortakët dhe aksionarët e shoqërisë tregtare nuk janë të mbrojtur vetëm nga dispozitat e të drejtës penale për përfaqësimin mashtrues, por edhe nga përgjegjësia civile e drejtorëve për veprime të tilla.

Megjithatë, në rrethana të tilla është e vërtetë se duhet të sqarohet dhe fuqizohet locus standi i ortakëve dhe aksionarëve për të kërkuar dëmshpërblim (shih seksionin 3 më poshtë).

Duke qenë se rregullat e përgjithshme për përfaqësimin dhe mbrojtjen e palëve të treta do të jenë të zbatueshme për të gjitha llojet e shoqërive tregtare, këto dispozita duhet të vendosen në seksionin e parë të ligjit, “Dispozita të përgjithshme”.

² Për penalitetet, shih më poshtë, në seksionin e fundit.

2. Përkufizim më i mirë i detyrave dhe kompetencave të drejtorëve

a) Përgjegjësitë e përgjithshme të besimit

Një instrument i rëndësishëm i drejtimit të shoqërive aksionare, *marrëdhëniet e besimit midis aksionarëve të ndryshëm të kompanisë*, nuk mbulohet si duhet në Ligjin nr. 7638 “Për shoqëritë tregtare”. Historikisht, përgjegjësitë e besimit nuk janë përcaktuar për partnerët (ortakët dhe aksionarët) përkundrejt partnerëve të tjerë, dhe për drejtorët dhe punonjësit përkundrejt organizatës. Në dritën e përgjegjësisive të balancuara, që kanë dalë në dritë gjatë debatit për drejtimin e kompanive aksionare, ka dalë një parim i ri i përgjithshëm. *Gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre të ortakërisë, partnerët, anëtarët dhe aksionarët janë të detyruar të marrin parasysh ashtu si duhet interesat e kompanisë dhe të partnerëve të tjerë, anëtarëve dhe aksionarëve* Gjatë tryezës së rrumbullakët janë përmendur këto shprehje të veçanta rregullatore të këtij parimi të “besimit reciprok”:

- Trajtim i barabartë i ortakëve, anëtarëve dhe aksionarëve në rrethana të njëjta;
- Të drejta për informacion të mjaftueshëm;
- Dispozita për shpërdorim me formën e shoqërisë;
- Ndalim i konflikteve të paligjshme të interesit (përfshirë një përkufizim të personave të “lidhur” dhe “me marrëdhënie”);
- Një rregullim i mjaftueshëm i sekreteve tregtare dhe i pasojave të shkeljes së tyre.

Pjesëmarrësit në pyetësor ishin dakord që një zgjidhje të mjaftueshme do ta ofronte një arkitekturë koherente e këtyre detyrave.

Edhe detyrat e përgjithshme të besimit duhet të jenë pjesë e Dispozitave të Përgjithshme të ligjit të ri, duke qenë se janë të zbatueshme për të gjitha format e shoqërive tregtare.

b) Kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorëve, përfshirë rregulla të qarta për konfliktin e interesit për të garantuar biznes të ndershëm

Gjatë tryezës së rrumbullakët doli qartë se në sistemin e tanishëm nuk janë të përcaktuara qartë kompetencat e organeve të ndryshme të shoqërive tregtare. Pjesëmarrësit në pyetësor theksuan se në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara (shpk) dhe shoqëritë anonime (sha) duhet të përcaktohen siç duhet kompetencat e administratorëve në raport me organet e tjera të shoqërisë për sa u takon vendimeve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Për shembull, në praktikën tregtare shqiptare ndodh shpesh që asambleja e aksionarëve përfshihet në çështje të punës së zakonshme, ndërkohë që kjo duhet të jetë

kompetencë vetëm e drejtuesve të shoqërisë. Është dhënë edhe sugjerimi që ligji i ri duhet të rregullojë më mirë strukturat e brendshme drejtuese të SHPK-ve.

Në lidhje me SHPK-të, ligji mund të ofronte mundësinë e një sistemi me bord të ngjashëm me SHA-të. Nëse do të ekzistonte një bord (administrues), duhet të vendosen dispozita të qarta për marrëdhënien midis administratorit të vetëm dhe bordit, përfshirë edhe përgjegjësitë në rast të shmangies nga vendimet e bordit.

Neni 98 i Ligjit Nr 7638 parashikon që gjykata mund ta quajë të pavlefshme heqjen e një drejtori nga këshilli mbikëqyrës në rast se heqja nuk është mbështetur në “baza të arsyeshme” ligjore ose nëse është bërë për arsye që nuk kanë të bëjnë aspak me interesat e shoqërisë. Në këtë nen renditen më konkretisht edhe disa prej këtyre bazave ligjore (dalje jashtë kompetencave, paaftësia për të kryer detyrat ose humbja e besimit nga organizata). Edhe këtu gjykatat kanë një shkallë dore të lirë për të përcaktuar këto “baza të arsyeshme” ligjore. Siç kemi theksuar më sipër, ky është roli i gjykatësve dhe nuk mund të evitohet.

Prapë se prapë, arsyet për heqjen e një drejtori duhet të jenë, në të vërtetë, sa më precize.

Është e debatueshme nëse një drejtor duhet kufizuar vetëm me dëmshpërblim për dëmin që i shkaktohet në rast të heqjes së padrejtë, siç kanë propozuar disa prej pjesëmarrësve në pyetësor. Ky mendim nuk merr sa duhet në konsideratë që heqja nga detyra mund të jetë bërë në mënyrë absurde, për shembull për të hequr qafe një drejtor të bezdisshëm i cili bëhet pengesë për interesat e një aksionari që ka shumicën e aksioneve.

Për rrjedhojë, ligji nuk duhet të kufizohet vetëm me të drejtat për dëmshpërblim monetar të një drejtori të hequr pa të drejtë.

Përgjegjësia e drejtorëve të SHPK-ve dhe SHA-ve duhet të mbështetet në detyra të veçanta të besimit krahas atyre të përgjithshme të përmendura në seksionin a). Në këto detyra përfshihen:

- Detyrat e besnikërisë kundrejt interesit më të mirë të shoqërisë tregtare, përfshirë edhe ato transaksione në të cilat drejtori ka një konflikt interesi.
- Detyrat e kujdesit dhe të aftësisë

Në veçanti, drejtoritë duhet ta dëmshpërblejnë shoqërinë, nëse kanë kryer transaksionet e mëposhtme në mënyrë të pandershme:

- Kthimi i kontributeve të aksionarët;
- Pagesa e interesave apo dividendëve për aksionarët;

- Nënshkrimi, marrja në pronësi, pranimi si peng ose tërheqja e aksioneve të veta të shoqërisë apo e aksioneve të një shoqërie tjetër;
- Shpërndarja e aktiveve të shoqërisë;
- Lejimi i vazhdimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë kur mund të parashikohet që nuk do të jetë në gjendje të shlyejë borxhet e veta (tregtimi i paligjshëm);
- Mos-vendosja e një sistemi të paralajmërimit të hershëm në lidhje me zhvillimet që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- Në rast të rritjes së kushtëzuar të kapitalit, emetimi i aksioneve në kundërshtim me qëllim e vendosur ose përpara se ato të jenë paguar plotësisht;
- Bërja e pagesave për anëtarët e bordit ose menaxherët;
- Dhënia e huave.

Nga pjesëmarrësit në pyetësor ka ardhur një propozim tjetër interesant: Për të evituar konfliktin e mundshëm të interesit, menaxherët nuk duhen lejuar të jenë menaxherë të shoqërive të tjera ose aksionarë (të mëdhenj) të shoqërive konkurrenente, me përjashtim të rastit kur asambleja e aksionarëve e heq një kufizim të tillë (ky rregull ka qenë i përfshirë në Kodin Tregtar Shqiptar të vitit 1932).

Kufizimi i së drejtës së drejtorëve (ekzekutivë dhe jo ekzekutivë) për të punuar edhe për shoqëri të tjera është në të vërtetë një instrument i rëndësishëm mbrojtjeje për interesin e shoqërisë dhe të aksionarëve të saj. Për rrjedhojë, këto propozime duhet të diskutohen me kujdes gjatë tryezës së ardhshme të rrumbullakët.

Për më tepër, është e rëndësishme, siç kanë theksuar disa nga pjesëmarrësit në pyetësor, që standardet e përgjegjësisë të përshtaten me ato që zbatohen në sistemin shqiptar për përgjegjësinë kontraktuale dhe për shkeljen e detyrimeve kontraktuale.

3. Mbrojtje më e mirë për aksionarët

Përgjegjësia e besimit që është përmendur më sipër përkundrejt dhe midis aksionarëve, është një mjet i përgjithshëm mbrojtjeje. E njëjta gjë mund të thuhet për rregulloret e grupeve të njësisive ekonomike, duke përfshirë edhe të drejtat e aksionarëve të vegjël. Mbrojtja e aksionarëve të vegjël është jetike për të krijuar gatishmëri të investuesit jashtë shoqërisë tregtare që të investojnë në atë shoqëri. Më poshtë jepen disa prej të drejtave të mbrojtjes të aksionarëve të vegjël:

- a) Të drejta për hetim të posaçëm (e drejta për t'i kërkuar gjykatës të urdhërojë një hetim të posaçëm dhe anulim të vendimeve të paligjshme të administratës së shoqërisë tregtare) dhe masat rrjedhëse në gjykatë;
- b) Bërja publike dhe kontrolli i rrogave dhe shpërblimeve të drejtorëve;
- c) Fuqizimi i funksioneve mbikëqyrëse të bordeve dhe futja e mundësisë së krijimit të komisioneve të posaçme në fusha kryesore. Masat e reja standard që duhen futur janë si më poshtë:
 - Nëse anëtarët e bordit emërohen drejtorë menaxhues ose ekzekutivë, duhet garantuar që shumica e bordit përbëhet nga drejtorë menaxhues *të pavarur* (!); përkufizimin e pavarësisë duhet ta japë ligji për shoqëritë tregtare;
 - Rolet e Kryetarit të Bordit dhe të Drejtorit të Përgjithshëm (presidentit) duhet të jenë të ndara; në situatat të ndërthurura, Kryetari duhet të ketë votën vendosëse, nëse nuk parashikohet ndryshe nga statuti;
 - Bordet duhet të organizohen në mënyrë të atillë që të kenë një numër të mjaftueshëm drejtorësh jo-ekzekutivë ose mbikëqyrës të pavarur që të luajnë një rol të efektshëm në fushat kryesore ku mundësia për konflikt interesi është veçanërisht e lartë. Për këtë qëllim, duhet të krijohen *komisione për shpërblimin dhe auditimin* pranë bordit (mbikëqyrës);

Pjesëmarrësit në pyetësor propozuan rritjen e të drejtës së aksionarëve të vegjël për t'u larguar nga shoqëria tregtare, si një instrument shtesë mbrojtjeje. Mbi të gjitha, Neni 47 i Ligjit Nr 7638, që kërkon që transferimi i aksioneve të një palë e tretë të miratohet nga tre të katërtat e ortakëve të tjerë, konsiderohet si tepër i fortë dhe me të cilin mund të abuzohet me lehtësi nga ortakët e tjerë (sidomos nëse ndërthuret me një praktikë vlerësimi të brendshëm të aksioneve e cila lejohet nga Neni 11).

Do të ishte e pëlqyeshme një e drejtë (opsionale) e para-blerjes për ortakët e tjerë (në bazë të të njëjtave kushte dhe çmime të ofruara nga pala e tretë). Mund të parashikohet një e drejtë tjetër për t'u larguar nga shoqëria tregtare nëse kjo shoqëri e ndryshon objektin e vet dhe fillon një aktivitet tregtar në të cilin aksionari nuk dëshiron të marrë pjesë për arsye etike ose morale. Këtë problem do të mund ta zgjidhte një e drejtë e thjeshtë për t'u larguar nga shoqëria, e cila parashikohet nga Neni 1106 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (Njoftimi i Partnerëve) për shoqëritë komandite (partneritetet) të thjeshta.

4. Rregullat minimaliste për mbrojtjen e kapitalit

Tryeza e rrumbullakët sugjeroi se SHPK-të duhet të kenë vetëm një kapital minimal nominal. Pjesëmarrësit në pyetësor u përgjigjën se 100 lekë do të ishte një shumë e arsyeshme. Nuk pati ndonjë mendim të përbashkët në lidhje me kapitalin minimal për shoqëritë anonime (SHA). Një zgjidhje do të ishte ulja kërkesës ligjore për kapital minimal në Nenin 78 të Ligjit Nr 7638 në 1 milion lekë për SHA-të pa ftesë publike për nënshkrim dhe 2 milion lekë për SHA-të me ftesë publike. Megjithatë, disa prej pjesëmarrësve në pyetësor u përgjigjën se është parë se kërkesat e tanishme ligjore për kapitalin për SHA-të kanë përbërë pengesë.

Për rrjedhojë, nëse nuk del ndonjë mendim tjetër, kërkesat ligjore për kapitalin e SHA-ve duhet të qëndrojnë siç janë.

Pjesëmarrësit në pyetësor sugjeruan se, edhe në rastin e SHPK-ve, kontributi në natyrë, përfshirë edhe shërbimet dhe kreditë, duhet të lejohet vetëm nëse janë dhënë vlerësimet dhe/ose garancitë financiare përkatëse nga ortakët ose aksionarët. Sidoqoftë, po të jetë e mundur të themelohet një SHPK me vetëm 100 lekë, një element i tillë rregullator mbase do të ishte i padobishëm. Nëse themeluesit e një SHPK-je do të donin të tregonin seriozitetin e tyre duke vendosur një vlerë të konsiderueshme kapitali themeltar, atëherë ata mund t'i vendosnin kërkesat të tilla për vlerësimin dhe garancinë me anë të statutit.

Për rrjedhojë, duhet marrë një vendim se cilat masa të mbrojtjes së kapitalit do të kishin kuptim në rrethana të tilla.

5. Rritje e fleksibilitetit dhe e zgjedhjes së strukturave të shoqërive

a) Zgjedhja e strukturave të bordit

Në tryezën e rrumbullakët pati konsensus se duhet ofruar një zgjedhje e strukturave të drejtimit të biznesit të cilat do t'iu lejonin shoqërive të zgjidhin struktura të njëfishta ose të dyfishta të bordit për SHA-të; Pjesëmarrësit në pyetësor u përgjigjën se kjo do ta rriste në të vërtetë aftësinë e Shqipërisë për të thithur investime të huaja. Në lidhje me struktura të bordit për SHPK-të, shih më sipër seksionin 2 b).

b) Sistemet moderne të komunikimit (për organizimin e asambleve të përgjithshme, etj.);

Në tryezën e rrumbullakët u dhanë sugjerime për futjen e mjeteve elektronike të komunikimit siç janë konferencat përmes internetit për takimet virtuale.

Pjesëmarrësit në pyetësor u shprehën në favor të këtyre dispozitave në ligj. Ata shpjeguan se në praktikë disa shoqëri i kanë futur tashmë në përdorim sisteme të tilla. Mirëpo, dispozitat ligjore në këtë fushë, në veçanti ato që synojnë të mbrojnë të drejtat e pakicës, konsiderohen më efektive se dispozitat nënligjore. Gjithashtu, aktet nënligjore që parashikojnë sisteme të tilla kanë hasur vështirësi për t'u njohur nga Zyra e Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit të Tiranës, sidomos për sa i takon origjinalitetit dhe vërtetimit të nënshkrimeve të vendosura në procesverbalin e mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Për rrjedhojë, është konsideruar si i domosdoshëm mbulimi i këtyre çështjeve me dispozita në ligjin e ri.

6. Një model adekuat për pjesëmarrjen e punonjësve

Në tryezën e rrumbullakët u ra dakort që sistemi i tanishëm i përfaqësimit të punonjësve në nivel bordi nuk funksionon. Për rrjedhojë, për të arritur konvergencë me standardet e BE-së, Shqipëria duhet të marrë në shqyrtim idenë e futjes së mundësisë për të krijuar një sistem me këshilla të punonjësve me të drejtat përkatëse për të marrë informacion dhe për t'u konsultuar.

Mirëpo, disa pjesëmarrës në pyetësor deklaruan se krijimi i një sistemi për t'u konsultuar me punonjësit do të ishte i efektshëm vetëm për shoqëritë e mëdha, ndërsa për shoqëritë e vogla kjo do të përbënte pengesë.

Mbetet për t'u diskutuar se cilat kufij duhen vendosur në lidhje me konsultimet me punonjësit. Për shembull, ndërmarrjeve me më shumë se 20 (apo 50?) punonjës duhet t'u kërkohet të ngrenë një këshill të punonjësve, ndërsa ato me një numër më të vogël punonjësish do të duhej të emëronin të paktën një përfaqësues të punonjësve. Këto dispozita duhet të jenë pjesë e Dispozitave të Përgjithshme të ligjit, duke qenë se do të ishin të zbatueshme për çdo lloj njësie ekonomike.

Disa prej pjesëmarrësve në pyetësor u përgjigjën se krijimi i një sistemi për konsultime me punonjësit (pa përfaqësim në bord) do të ishte një ndërhyrje e shpërpjesshme në të drejtën për të kryer aktivitetin tregtar. Sidoqoftë, *sistemi i legjislacionit evropian për shoqëritë tregtare dhe standardet e përgjegjësive sociale e parashikojnë, pa dyshim, si detyrim sistemin e konsultimeve me punonjësit.* Për më tepër, studime të shumta kanë treguar se sot më shumë se kurrë kur e kryen aktivitetin tregtar përmes konsultimeve me punonjësit madje edhe përmes përfshirjes së tyre në marrjen e vendimeve realizohen më shumë fitime se në kushtet kur ndiqet qasja tradicionale.

7. Dispozita adekuate për shoqëritë tip ‘holding’ dhe grupet e shoqërive

Ligji shqiptar parashikon rregullat bazë të një ligji të grupeve të shoqërive. Këto rregulla përcaktojnë detyrat për informacion për shoqëritë e përfshira dhe të drejtat përkatëse për aksionarët. Ato kufizojnë edhe mundësinë e mbajtjes së ndërsjelltë të aksioneve. Mendimet e shprehura në tryezën e rrumbullakët evidentuan mungesën e rregullave për administrimin e unifikuar të grupeve të shoqërive tregtare dhe dëmin që mund t’i shkaktojë një gjë e tillë shoqërive filial (të varura).

Pjesëmarrësit në pyetësor shtuan se përkufizimi i kontrollit duhet të jetë disi i gjerë në mënyrë që të përfshijë edhe llojet e reja të strukturave tip “holding” të cilat kanë “influencë” në pavarësinë e një shoqërie tregtare.

Çfarë lloj parametrash do të duhet të përdoren për të përcaktuar mekanizmin e kontrollit për të shkuar përtej përqindjes së aksioneve që parashikohet nga ligjet për kombinimin e njësive ekonomike?

8. Drejtim i qartë i brendshëm për shoqëritë me një ortak

Koncepti mbi të cilën mbështetet Direktiva e Dymbëdhjetë është nxitja dhe zhvillimi i firmave të vogla dhe ngritja e personave fizikë në nivelin e shoqërive tregtare, e cila konsiderohet se përfaqëson kuadrin më të mirë për zhvillimin e biznesit në tregun e brendshëm. Personat fizikë mund të gëzojnë privilegjin e përgjegjësisë së kufizuar. Gjithashtu ky koncept mund të përdoret nga kompanitë nëna për krijimin e filialeve me pronësi të plotë, si një mjet për të kufizuar rreziqet e caktuara, për aktive të caktuara.

Pjesëmarrësit në pyetësor u shprehën qartë se *ligji i ri nuk duhet të kufizojë krijimin e disa shoqërive me një ortak nga i njëjti person, por të parashikojë masa mbrojtëse për veprimet mashtruese, për shembull duke kufizuar në mënyrë të mprehtë kontratat midis shoqërisë dhe aksionarit, me anë të dispozitave për strukturat e bordit dhe duke mbrojtur ortakët e vegjël dhe kreditorët me anë të detyrave të besimit dhe të ligjit për grupet e shoqërive tregtare.*

Në këtë kontekst u tha edhe se standardet e përgjegjësisë që zbatohen nga gjykatat në Shqipëri kanë lidhje të fortë me standardet që zbatohen për dosjet penale, duke u përbërë pengesë, kështu, për përgjegjësinë civile në ato raste kur gjykatat nuk pranojnë të vendosin sanksione penale.

9. Rregullim i qartë i drejtimit të brendshëm financiar të shoqërive tregtare (bilanci dhe auditimi)

Ligji i ri “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” parashikon detyrimin për publikimin e bilancit vjetor. Standardet e raportimit financiar mund të gjenden në Ligjin për Kontabilitetin. Në lidhje me këtë, ligji për shoqëritë tregtare mund të forcojë transparencën dhe mundësinë e marrjes së informacionit financiar përmes përgjegjësive konkrete të drejtorëve.

Një pyetje tjetër ishte nëse duhet të ishin pjesë e ligjit për shoqëritë tregtare kërkesat e reja ligjore të BE-së në lidhje me auditorët, ose nëse këto duhet të futeshin në ligjin për kontabilitetin ose një ligj të posaçëm për auditimin. Deri tani, këtë çështje e kanë mbuluar Nenet nga 168 deri në 185 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Disa pjesëmarrës në pyetësor u përgjigjën se edhe dispozitat e reja për audituesit duhet të ishin pjesë e ligjit për shoqëritë tregtare. Por, pjesëmarrësit e tjerë në pyetësor donin që këto rregulla të mbuloheshin nga ligj i veçantë.

Duke qenë se rregullat për auditimin janë të zbatueshme për organizata të tjera që nuk mbulohen nga ligji për shoqëritë tregtare, do të jepnim rekomandimin që këto rregulla të vendoseshin në një ligj të posaçëm. Është e mira që kjo çështje të shtrohej përsëri për diskutim.

10. Futja e kodeve të drejtimit të shoqërive tregtare dhe e statuteve model

Për të rritur reagimin e rregullimit të shoqërive ndaj ndryshimeve sugjerohet që Shqipëria të fusë në përdorim një Kod të Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare dhe modele të statuteve të shoqërive tregtare të cilët do të mund të ndryshoheshin pa pasur nevojë për legjislacion.

Disa prej pjesëmarrësve në pyetësor i konsideruan kodet e drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare si të përshtatshme vetëm për shoqëritë e regjistruara në bursë dhe vunë në dyshim aktualitetin e tyre për Shqipërinë ku tregjet e kapitalit janë inekzistent. Sidoqoftë, ata dhanë mendimin se në ligjin e ri për shoqëritë tregtare mund të teshin referenca të tilla si Kodi, për t’u paraprirë zhvillimeve të ardhshme. Mirëpo, një pjesë tjetër e pjesëmarrësve në pyetësor thanë se për shkak të praktikës shqiptare do të neglizhohej kontrolli i zbatimit ligjor të çfarëdo dokumenti që nuk është akt ligjor, nënligjor apo administrativ. Për rrjedhojë, një Kod i Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive duhet të ketë formën e një ligji apo të një vendimi të këshillit të ministrave në mënyrë që të jetë një dokument i cili të merret në konsideratë nga gjykatat për të bërë një interpretim më të mirë të dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare.

Duhet marrë një vendim nëse duhet të miratohet një kod për drejtimin e brendshëm të shoqërive dhe çfarë forme do të kishte ky kod, me t'u miratuar ligji i ri, në mënyrë që të ofrohet një përmbledhje e pikëpamjeve që jep ligji për drejtimin e brendshëm dhe për ta mbajtur atë të hapur ndaj zhvillimeve të mëtejshme të biznesit dhe profesioneve ligjore.

11. Një sistem adekuat penalitetesh

Në tryezën e rrumbullakët u evidentua se ka boshllëqe të ndjeshme në lidhje me kontrollin e zbatimit ligjor të rregulloreve. Disa prej pjesëmarrësve në pyetësor ngritën akuza në lidhje me shpërdorimin e shpeshhtë të detyrave të administratorëve duke i shpërfillur të drejtat e aksionarëve dhe duke përdorur metoda mashtruese.

Disa pjesëmarrës të tjerë në pyetësor thanë se, për sa u takon sanksioneve penale, *çdo penalitet i futur në ligjin e ri për shoqëritë tregtare duhet të bashkërendohet në mënyrë të ngushtë me dispozitat ekzistuese të Kodit Penal, në mënyrë që të evitohet mospërputhja midis legjislacioneve të ndryshme, duke pasur gjithashtu në konsideratë se, në krahasim me ligjet e zakonshme, Kodi Penal ka një status më të lartë kushtetues.*

12. Aksione të regjistruara apo aksione të prurësit

Sistemi shqiptar vazhdon të parashikojë aksione të prurësit dhe aksione me emër të regjistruar (Neni 198). Aksionet e prurësit janë të transferueshme pa asnjë procedurë të zyrtarizuar ndërsa aksione me emër të regjistruar (ose "aksione në emër") kërkojnë regjistrimin e transferimit të pronësisë. Një reformë, që u zbatua në vitin 1995, futi përmes Nenit 197-1 një regjistër të posaçëm për aksionet për shoqëritë me më shumë se 50 aksionarë. Reforma e legjislacionit të letrave me vlerë, nën drejtimin e Ministrisë së Financave, së bashku me prirjen drejt letrave me vlerë të përgjithshme të dematerializuara, nënkupton shfuqizim të aksioneve të prurësit. Vetëm aksionet e regjistruara parashikohen nga ligji i ri për letrat me vlerë. Megjithatë, pjesëmarrës të tjerë në pyetësor kanë treguar se aksionet e prurësit duhet të vazhdojnë të ekzistojnë.

Për rrjedhojë, krahasueshmëria midis legjislacionit të ri për letrat me vlerë dhe ligjit të ri për shoqëritë tregtare kërkon një vendim në lidhje me çështjen e aksioneve të prurësit.

13. E drejta e zbatueshme: Selia e regjistruar apo vendndodhja e vërtetë e aktivitetit

Sikurse ligje të tjera në rajon, Neni 4 i Ligjit nr. 7638 ndjek *doktrinën e selisë reale*, pra, ligji kompetent është territori ku ndërmarrja ka në fakt zyrën e saj kryesore. Në këto rrethana, autoritetet rregullatore kanë më shumë kontroll mbi veprimtarinë e kompanisë. Ka një mosmarrëveshje në gjithë Bashkimin Evropian në lidhje me faktin nëse kjo doktrinë apo doktrina e selisë së regjistruar është baza e duhur për harmonizimin evropian. *Doktrina e selisë së regjistruar* lejon që një shoqëri ta zgjedhë vetë vendin e regjistrimit, pa patur parasysh vendin ku kryhet konkretisht biznesi i saj. Kjo do të thotë që një shoqëri e regjistruar në Shqipëri mund ta bëjë të gjithë aktivitetin e vet tregtar jashtë vendit.

Këto dy koncepte, në të vërtetë, çojnë në një përplasje midis dy strategjive rregullatore. Nga njëra anë qëndrojnë parimet e lirisë së *krijimit të biznesit dhe mos-diskriminimit* mbi baza kombësie, që janë gjithashtu edhe dy shtyllat bazë të Tregut të Brendshëm të BE-së.³ Në anën tjetër *qëndron e drejta e shtetit, në të cilën zhvillohet veprimtaria e njësisë ekonomike në fjalë, ta rregullojë dhe kontrollojë këtë veprimtari dhe mbi të gjitha, t'ia nënshtrojë atë tatimeve kombëtare*. Nuk është bërë ende i mundur pajtimi i këtyre dy pikëpamjeve. Në katër vendime të rëndësishme⁴, Gjykata Evropiane (GJE) ka ndjekur përjashtjen e sipërpërmendur pragmatiste. GJE-ja njeh, nga njëra anë, shkaqet që fshihen pas doktrinës së "selisë reale", pra, të drejtën e shtetit për të mbrojtur interesat e kreditorëve, aksionarëve të vegjël, punonjësve, apo tatimet si "arsye të detyrueshme për të mirën e përgjithshme", të cilat mund të legjitimojnë kufizimin e lirisë së krijimit të biznesit, pa u konsideruar si diskriminuese. Nga ana tjetër, mosnjohja e personalitetit ligjor të një njësie ekonomike, si e tillë, është një kufizim i lirisë së vendosjes, e cila nuk mund të legjitimohet me anë të "arsyeve të detyrueshme të së mirës së përgjithshme" siç rezulton de facto kur mohohet plotësisht e drejta e krijimit të biznesit.

Kjo do të thotë se doktrina e "selisë reale", që është ligji në fuqi në Shqipëri, kryesisht pranohet nga GJE-ja. Megjithatë, asnjë shtet nuk mund të zbatojë të gjithë ligjin e tij për njësitë ekonomike pa kufizime të cilat rrjedhin nga liria e tyre për të krijuar (regjistruar) biznes. *Zbatimi i mekanizmave mbrojtëse nuk mund të përjashtojë lirinë e regjistrimit të biznesit, si të tillë*. Si rrjedhojë, vendet mund të zbatojnë doktrinën e "selisë reale" në rast se merret parasysh fryma e Nenit 48 të Traktatit të BE-së.

³ Nenet 43 dhe 48 të Traktatit të KE-së.

⁴ Lënda 212/97, *Centros*; Lënda 208/00, *Überseering*; Lënda 167/01, *Inspire Act*; Lënda 411/03, *Sevic*.

Kjo do të thotë që *ndërmarrjet e huaja duhen njohur dhe regjistruar në një vend si degë, në rast se janë themeluar ligjërisht jashtë vendit*. Një ndërmarrje e tillë mund pra të nënshkruajë kontrata në vend, të bëjë padi në gjykatë, të krijojë filiale apo të marrë në pronësi aksione të ndërmarrjeve të vendit

Disa prej pjesëmarrësve në pyetësor sugjeruan një ndryshim të regjimit dhe propozuan futjen në Shqipëri të qasjes së selisë së regjistruar. Ata deklaruan se autoritetet shqiptare kanë vështirësi për të vlerësuar se ku është selia reale e një shoqërie tregtare, duke përdorur kriteret objektive, për të përcaktuar se cili territor kompetence e mbulon shoqërinë në fjalë. Pjesëmarrës të tjerë në pyetësor ngulnin këmbë për ta ruajtur rregullin e tanishëm në mënyrë që të ketë një kontroll të fortë mbi shoqëritë tregtare, sidomos mbi ato të cilat bëjnë evazion fiskal dhe pastrim parash.

Për rrjedhojë, mbetet ende për t'u diskutuar nëse reforma për ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare duhet apo jo të konfirmojë zbatimin e doktrinës së selisë reale apo të kalojë drejt doktrinës së selisë së regjistruar.

14. Personi fizik: njësia ekonomike vetjake

Kur të përfundojë reforma e regjistrimit, Ligji nr. 7632 "Për pjesën e përgjithshme të Kodit Tregtar" do të ketë vetëm një aspekt rregullator: rregullat për "tregtarin" apo personin fizik të sipërmarrje së vetme. Dallimi midis kësaj figure ligjore dhe veprimtarive të saj "tregtare" mendohet se përcakton kohën kur duhet të regjistrohet një tregtar i tillë. Studimi i GTZ-së i vitit 2002 shpjegon se këto rregulla tregtare të stilit të shekullit XIX janë shfuqizuar ndërkohë edhe në sistemin ligjor gjerman, nga ku janë marrë fillimisht I vetmi problem që ka rëndësi sot është organizimi i biznesit të personit fizik si i tillë, sepse mund të ketë një përqindje të rëndësishme në treg dhe si rrjedhojë duhet të bëhet e ditur për publikun e interesuar Ligjet kontinentale u kanë atribuar "njësive ekonomike vetjake të tilla" privilegje dhe detyrime të veçanta (uljen e formaliteteve të kontraktimit, detyrimin e reagimeve të shpejta në rastin e propozimeve kontraktuale apo defekte të mallrave, standarde të veçanta të përgjegjësisë për sa i përket aftësive profesionale, etj.). Këto privilegje dhe detyrime zbatohen vetëm për ata persona fizik, veprimtaria e të cilëve kërkon, për shkak të vëllimit të saj, një formë të organizuar biznesi. Kjo do të thotë se ligji përkatës duhet të përcaktojë një prag limit (pse t'ia japë kompetencën për përcaktimin e këtij limit Ministrisë së Ekonomisë dhe të Tregtisë) duke përcaktuar kështu gamën dhe vëllimin e biznesit, nga të cilët duhet nisur edhe përshtatshmëria e sipërmarrjes dhe regjistrimit Veprimtari ekonomike, të cilat, për shkak të vëllimit të tyre, nuk kërkojnë një organizatë të zakonshme biznesi (biznese të vogla) nuk duhet t'i nënshtrohen rregullave të posaçme të njësive ekonomike vetjake dhe regjistrimit.

Disa prej pjesëmarrësve në pyetësor deklaruan se dallimet rregullatore të Neneve 3 dhe 7 të Ligjit Nr 7632 duhet të ruhen dhe se statusi i personit fizik të mos lidhet me kufirin e poshtëm të vëllimit të biznesit. Disa të tjerë e konsideronin këto kufi minimal të nevojshëm për të evituar regjistrimin e bizneseve të vogla.

Problemi që vëmë re ne është se në një botë gjithnjë në ndryshim, me biznese dhe shërbime të reja, është thujse e pamundur të përcaktosh se cilat aktivitete tregtare janë të rëndësishme aq sa për t'u dhënë një status të veçantë ligjor. Për rrjedhojë, do të sugjeronim që kjo çështje të vijojë të diskutohet.

Fokusi i ri ligjor te karakteri organizativ është shkaku përse ligjet e tjera për shoqëritë tregtare në rajon, të hartuar gjatë viteve të fundit, i kanë vendosur rregullat për "njësitë ekonomike vetjake " në ligjet e tyre për shoqëritë tregtare. Si rrjedhojë, ligji për shoqëritë tregtare bëhet një ligj koherent për të gjitha llojet e organizatave të biznesit

Pjesëmarrësit në pyetësor ishin dakord që ligji i ri për njësitë ekonomike të përkufizonte termin “ndërmarrje” (njësi ekonomike) dhe të parashikonte rregullat për sipërmarrësit e vetëm (personat fizikë). Ligji Nr 7632 duhet të shfuqizohet.

15. Dokumenti i themelimit dhe i organizimit

Nëse krahasohet ligji shqiptar për shoqëritë tregtare me ligjet e tjera në rajon, shumë komentues të huaj e kanë komentuar si avantazh faktin që Neni 3 i Ligjit 7638 kërkon vetëm një dokument për themelimin dhe organizimin e shoqërive tregtare. Përvoja me ligjet në rajon të cilat kërkojnë një akt-marrëveshje themelimi apo “statut” dhe “akte nënligjore” ka treguar se kjo zgjidhje me dy dokumente zakonisht sjell mbivendosje të panevojshme në përmbajtjen e këtyre dokumenteve. Dyfishimi i dokumenteve të cilët përmbajnë të paktën të njëjtat dispozita mund të sjellë rrezikun e konfuzionit në lidhje me dallimin midis të dy dokumenteve. Kjo është sidomos shqetësuese nëse palët e treta duan të informohen për përmbajtjen e këtyre dokumenteve, për shembull, në lidhje me faktin se kush ka të drejtë ta përfaqësojë njësinë ekonomike.

Zgjidhja me një statut sigurisht që nuk e pengon një njësi ekonomike të krijojë akte nënligjore të brendshme për drejtimin e vet të brendshëm. Po kështu, edhe zgjidhja me një statut e së drejtës klasike kontinentale nuk do të thotë që reforma e ligjit për shoqëritë tregtare të mos fusë struktura “klasike” anglo-saksone për pjesën tjetër të shoqërive tregtare, për shembull, struktura me një bord si një mundësi zgjedhjeje alternative ndaj strukturës me dy borde.

Pjesëmarrësit në pyetësor ishin dakord me faktin që zgjidhja me një statut do ta pakësonte kompleksitetin e panevojshëm.